



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi
18 Gusht 2022

Informata e parë – 2022

i/e nderuar,

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Junikut, deri tani ka mbajtur katër takime, ashtu si parashihet me Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB–03/2012MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.

Në mbledhjen e parë të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur më datë 16 Maj 2022, është bërë Konstituimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, pastaj është diskutuar për gjendjen e sigurisë në Komunën e Junikut duke theksuar se Policia e Kosovës është duke e monitoruar gjendjen dhe se siguria në Komunën e Junikut është e qetë dhe pa raste që mund të cenonin sigurinë, si dhe në pikën e të ndryshme janë diskutur dhe shprehur shqetësimet për qështje të caktuara e të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e qytetarëve të Komunës së Junikut dhe më gjërë. Mbledhjen e parë e ka kryesuar z.Ruzhdi Shehu, Kryetar i Komunës Junik.

Në mbledhjen e dytë të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur më datë 01 Qershor 2022, është diskutuar për gjendjen e sigurisë në Komunën e Junikut, ku theksojmë që gjendja e sigurisë është e qetë ndërsa sfidë në vete për Policinë është mungesa e zyrtarëve Policor, është diskutuar dhe miratuar plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022, është diskutuar për gjendjen me pandeminë COVID-19, ku u tha se gjendja me pandeminë është stabile dhe me pak raste pozitive me virusin COVID-19, gjithashtu në këtë mbledhje antarët kërkuan që të kenë një raport mbi gjendjen e kamerave të sigurisë në qytet, si dhe krahas shumë qështjeve tjera u diskutua dhe për qenët endacak të cilët mbeten shqetësim në Komunën e Junikut. Mbledhjen e dytë e ka kryesuar z.Besart Tofaj, Nënkryetar i Komunës Junik.

Në mbledhjen e tretë të rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur më datë 28 Qershor 2022, është diskutuar për shumë qështje duke filluar me sigurinë në Komunën e Junikut ku u tha se gjendja e sigurisë është kryesisht e qetë dhe pa raste që mund të cenonin sigurinë gjithashtu në këtë pikë u tha se Policia e Kosovës do t'i kushtoj vëmendje të veçantë muajve Korrik dhe Gusht pasi që kemi fluks më të madh të ardhjes së mërgimtarëve dhe se Policia ka bashkëpunim të mirë edhe me lokalet e gastronomisë me qëllim ruajtjen e sigurisë, në këtë mbledhje u raportua edhe për gjendjen e kamerave të sigurisë në qytet ku u tha se kamerat nuk janë në funksion dhe se është duke u përgatitur projekti për funksionalizimin edhe mirëmbajtjen e tyre, ndërsa në pikën e të ndryshme u diskutua edhe për kushtet dhe vështirësitë e zjarrefiksive si dhe shumë qështje të cilat edhe janë adresuar. Mbledhjen e tretë e ka kryesuar z.Besart Tofaj, Nënkryetar i Komunës Junik.